

BLUE TDI sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022



PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2022**

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	904,314	1,000,754
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	173,680	105,319
Total aktive afatshkurtra		1,077,994	1,106,073
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	426,352,828	418,645,449
Total aktive afatgjata		426,352,828	418,645,449
Total aktive		427,430,822	419,751,522
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	7	16,794,081	18,457,562
Llogari të pagueshme tregtare	8	50,261	38,320
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	9	1,787,144	47,771
Detyrime tatimore	10	1,152	1,016
Të tjera detyrime	11	66,844	29,910
Total detyrime afatshkurtra		18,699,482	18,574,579
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	12	127,482,673	152,060,194
Total detyrime afatgjata		127,482,673	152,060,194
Totali i detyrimeve		146,182,155	170,634,773
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	13	275,807,856	251,210,298
Rezerva të tjera		(2,093,549)	(1,101,258)
Fitimi/(humbja) e ushtrimit		7,534,360	(992,291)
Total kapitali		281,248,667	249,116,749
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		427,430,822	419,751,522

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto	14	(56,822)	(63,400)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(562,450)	(544,771)
1) Të tjera shpenzime	15	(562,450)	(544,771)
Shpenzime të personelit	16	(392,562)	(384,120)
1) Paga dhe shpërblime		(386,000)	(360,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(6,562)	(24,120)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(193)	-
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime/të ardhura financiare neto	18	8,546,387	-
1) Shpenzime të tjera financiare		8,546,387	-
Fitimi/humbja para tatimit		7,534,360	(992,291)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit	19	7,534,360	(992,291)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		7,534,360	(992,291)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BLUE TDI sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimi / (humbja) e ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	225,859,743	(709,355)	(391,903)	224,758,485
Fitimi / (Humbja) e ushtrimit	-	-	(992,291)	(992,291)
Lëvizjet përmes kapitalit	-	(391,903)	391,903	-
Rritje e kapitalit nga ortakët	25,350,555	-	-	25,350,555
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	251,210,298	(1,101,258)	(992,291)	249,116,749
Fitimi / (Humbja) e ushtrimit	-	-	7,534,360	7,534,360
Lëvizjet përmes kapitalit	-	(992,291)	992,291	-
Rritje e kapitalit nga ortakët	24,597,558	-	-	24,597,558
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	275,807,856	(2,093,549)	7,534,360	281,248,667

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më:

Ana Lleshi

Znj. Ana Lleshi

Administrator



Mazars Shpk
mazars
Ukshi Hoti Shk.
10000, Pristina, Kosova
Cert. of Reg: 811335597

Mazars shpk

Hartues i Pasqyrave Financiare

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi/humbja e ushtrimit		7,534,360	(992,291)
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative		57,734	63,350
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(68,361)	1,928,752
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		11,657	(83,719)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		37,354	3,932
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		7,572,744	920,024
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(7,707,379)	(5,016,573)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(7,707,379)	(5,016,573)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit		24,597,558	25,350,555
Pagesa e huave		(24,501,629)	(22,318,472)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		95,929	3,032,083
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(38,706)	(1,064,466)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		1,000,754	2,128,570
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(57,734)	(63,350)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	904,314	1,000,754

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“BLUE TDI” sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 25.07.2019 dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 26/07/2019 në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 275,807,856 Lekë, i ndarë në 3 kuota.

Ortakët e shoqërisë janë si më poshtë:

- WSI Shpk, zotërues i 1 kuote ose 45 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 124,113,535 lekë.
- GBI, zotërues i 1 kuote ose 22.5 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 62,056,767 lekë.
- Matrix Konstruksion zotërues i 1 kuote ose 32.5 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 89,637,554 lekë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është investimet e ndryshme direkte ose indirekte në fushën e turizimit, ndërtim dhe/ose zhvillim i objekteve të ndryshme në fushën e turizimit dhe të hotelërisë, menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve shoqëruese dhe zhvilluese të turizimit/hotelërisë, shërbimeve të akomodimit, logjistikës dhe çdo aktivitet që lidhet me to. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, dhënie/marrje me qira ose vënien e hipotekave që mund të konsiderohet e dobishme ose e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe çdo aktivitet tjetër që direkt apo indirekt lidhet me objektin e aktivitetit të sipërpërmendur siç mund të konsiderohet e domosdoshme ose e dobishme ose ndihmëse në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme sipas diskrecionit të vetë shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Nr 6, Kati i I, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L91926023K.

Më 31 dhjetor 2022 Shoqëria kishte 1 punonjës, (2021: 1 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
Euro/LEK	114.23	120.76
USD/ LEK	107.05	106.54

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25 %
Automjetet	Vlera e mbetur	20 %
Mobilje dhe orëndi për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 0% (2021: 0%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në bankë	904,314	1,000,754
Llogari rrjedhëse	904,314	1,000,754
	904,314	1,000,754

5. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
TVSH e kreditueshme	173,680	105,319
	173,680	105,319

6. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Aktiv afatgjatë në proces	Totali
Kosto			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	378,261,594	35,367,282	413,628,876
Shtesa	2,000,000	3,016,573	5,016,573
Gjendja më 31 dhjetor 2021	380,261,594	38,383,855	418,645,449
Shtesa	-	7,707,379	7,707,379
Gjendja më 31 dhjetor 2022	380,261,594	46,091,234	426,352,828
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	-	-
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	378,261,594	35,367,282	413,628,876
Gjendja më 31 dhjetor 2021	380,261,594	38,383,855	418,645,449
Gjendja më 31 dhjetor 2022	380,261,594	46,091,234	426,352,828

7. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Këstet e kredisë afatshkurter Credins Bank	16,794,081	18,457,562
	16,794,081	18,457,562

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Furnitorë vendas	50,261	38,320
	50,261	38,320

9. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të pagueshme ndaj Matrix Konstruksion	251,384	24,235
Të pagueshme ndaj GBI	1,535,760	23,536
	1,787,144	47,771

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,152	1,016
	1,152	1,016

11. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime ndaj personelit	66,844	29,490
Te tjera detyrime	-	420
	66,844	29,910

12. Hua afatgjata

Huaja afatgjatë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Hua afatgjatë nga Credins Bank	127,482,673	152,060,194
	127,482,673	152,060,194

13. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 275,807,856 Lekë. Shoqëria ka rezultuar me fitim 7,534,360 Lekë gjatë vitit 2022. Në datën 13.12.2022 është bërë rritje e kapitalit të shoqërisë si më poshtë vijon:

Ortaku	Nr. i kuotave	% e pjesëmarrjes	Vlera e kapitalit fillestar	Rritja e kapitalit	Total i vlerës së kapitalit më 31.12.2022
WSI	1	45.00%	113,044,634	11,068,901	124,113,535
Matrix Konstruksion	1	32.50%	81,643,347	7,994,207	89,637,554
GBI	1	22.50%	56,522,317	5,534,450	62,056,767
Total		100%	251,210,298	24,597,558	275,807,856

14. Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Fitime nga këmbimet valutore	13,576	9,509
Humbje nga këmbimet valutore	(70,398)	(72,909)
	(56,822)	(63,400)

15. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Konsulenca ekonomike	341,814	354,238
Shpenzime qiraje	118,204	73,440
Taksa vendore	74,500	74,500
Komisione bankare	23,932	36,393
Shpenzime administrative dhe noteriale	4,000	6,200
	562,450	544,771

16. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime për paga	386,000	360,000
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6,562	24,120
	392,562	384,120

17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Gjopa dhe penalitete	193	-
	193	-

18. Shpenzime/të ardhura financiare neto

Shpenzime/të ardhura financiare neto paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime të tjera financiare	8,546,387	-
	8,546,387	-

19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	7,534,360	(992,291)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë):	193	-
Shpenzime pa dokument të rregullt tatimor	193	-
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	7,534,553	(992,291)
Humbje fiskale e mbartur	(689,355)	-
Fitimi fiskal i tatueshëm	6,845,198	-
Tatimi mbi fitimin 0%	-	-
Fitimi i vitit	7,534,360	(992,291)

20. Transaksione me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Balanca me palët e lidhura		
Hua Matrix Construcion	251,384	24,235
Hua GBI	1,535,760	23,536
	1,787,144	47,771

21. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2022 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

22. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas periudhës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare